



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2025

Lënda: Kthim përgjigje.

Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, ju informojmë si më poshtë vijon:

- **Sa raste të dhunës në familje ka trajtuar në pesë vitet e fundit, specifikoni sipas viteve?**

Bashkangjitur gjeni tabelën me të dhënat përkatëse të rasteve sipas viteve.

NR.	VITI	RASTE
1	2020	121
2	2021	150
3	2022	110
4	2023	64
5	2024	140

- **Sa prej këtyre rasteve të verifikuara kanë qenë dhunë me bazë gjinore?**

Të gjitha rastet janë raste të dhunës me bazë gjinore.

- **A ka Bashkia qendër për strehimin e personave denoncues të dhunës në familje? Nëse po specifikoni rreth saj:**
- **Sa punonjës shërbejnë, çfarë ofron qendra, ku ndodhet ajo?**
- **Sa ka qenë fondi i venë në dispozicion për këtë qendër për pesë vitet e fundit, specifikoni sipas viteve?**
- **Nëse Bashkia nuk ka një qendër të tillë a ka pasur projekte për hapje të saj, nëse po përse nuk është realizuar dhe kur do të realizohet?**

Strehëza emergjente për viktimat e dhunës në familje është e ngritur në Bashkinë Shkodër, që prej vitit 2016, si një shërbim emergjent, bazuar në detyrimin e parashikuar në Ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, Ligjin

Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror.”

Menaxhimi i Strehëzës bëhet në mënyrë të përbashkët midis Bashkisë Shkodër dhe Organizatës “Gruaja tek Gruaja”, një organizatë jofitimprurëse, e cila ka si objekt të veprimtarisë së saj shërbime psiko-sociale për gra, fëmijë dhe familjen.

Marrëdhëniet institucionale janë të rregulluara nëpërmjet Marrëveshjes së Bashkëpunimit, të lidhur midis Bashkisë Shkodër dhe Organizatës “Gruaja tek Gruaja Shkodër”. Qëllimi i kësaj marrëveshje është fuqizimi i shërbimit emergjent për viktimat e dhunës në familje, si dhe rritja dhe forcimi i kapaciteteve të mekanizmit të referimit.

Në terma të mbulimit të shpenzimeve buxhetore, Bashkia Shkodër ka vënë në dispozicion ambientin dhe mbulon pagesat për energjinë elektrike dhe ujin. Organizata mbulon të gjitha shpenzimet e tjera, për ushqimin, veshmbathje, shërbimet dhe pagesat e punonjësve, nëpërmjet projekteve të ndryshme me donator.

Në këtë strehëz ofrohen qëndrimi i sigurt, shërbim psiko-social, mbulim i nevojave me veshmbathje, ushqim, këshillim individual, asistencë ligjore, menaxhim dhe referim i rasteve në shërbime të tjera. Përfitueset dhe fëmijët e tyre qëndrojnë në këtë strehëz nga 48 orë deri në 14 ditë, bazuar kjo në situatën e përfitueseve dhe marrjen e vendimeve të gjykatës për pajisjen me urdhër të menjëhershëm mbrojtje dhe/apo urdhër mbrojtje. Gjithashtu, në strehëz jepet shërbim ditor për fëmijët 0-6 vjeç, viktimat direkte ose indirekte të dhunës në familje, të shoqëruar nga nënat e tyre.

Strehëza Emergjente për viktimat e dhunës në familje, ndodhet në një godinë në pronësi të Bashkisë Shkodër. Vendndodhja është në një zonë të qetë dhe të sigurt të qytetit. Vendndodhja e strehëzës nuk është publike dhe e aksesueshme për këdo, kjo për të shmangur çdo rrezik për viktimat, duke qenë se brenda qytetit të Shkodrës mund të kishte një potencial rreziku për viktimat. Mospublikimi i adresës së strehëzës mban larg dhunuesit nga viktimat si dhe shmang rrezikun dhe frikërat për praninë e dhunuesit përreth zonës së vendndodhjes së saj. Kjo vjen në përputhje me një nga standardet për strehëzat, lidhur me fshehtësinë e shërbimeve të tilla.

Në bashkinë e Shkodrës operon dhe ushtron aktivitetin e saj edhe strehëza e përkohshme e Papa Xhovani XXIII, me të cilën bashkëpunimi në menaxhimin e rasteve ka qenë i vazhdueshëm.

Bashkia Shkodër në bashkëpunim me organizatën “Të ndryshëm të barabartë” ka të ngritur dhe funksionale edhe një qendër ditore që ofron shërbime me orare të zgjatura dhe në fundjavë, për fëmijët e rasteve të dhunës në familje, VMT apo VT. Aktualisht në këtë qendër marrim shërbim 17 fëmijë.

Me qëllim fuqizimin socio-ekonomik dhe riintegrimin e tyre në shoqëri për kategoritë vulnerabël si grate viktime të dhunës në familje janë parashikuar lehtësira në paketën fiskalë të Bashkisë Shkodër, duke i përjashtuar nga pagesa e çerdheve dhe kopshteve.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR

Benet Beci